

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TE ULËT

LËNDA: GJEOGRAFI

(klasa e nëntë)

Tiranë, mars 2007

1. TË PËRGJITHSHME

Në programin e ri të lëndës së gjeografisë për klasën e nëntë të shkollës 9 -vjeçare janë konsoliduar ndryshimet e bëra në programin e fundit të gjeografisë së klasës së tetë (2000), në të cilën është zhvilluar Gjeografia e Shqipërisë dhe e trevave të tjera shqiptare. Njëherazi janë përfshirë trajtime të tjera, të cilat theksojnë përmbajtjen shkencore të saj dhe e aktualizojnë atë me problemet më të reja të gjeografisë së Republikës së Shqipërisë dhe të trevave të tjera shqiptare në Ballkan. Në ndërtimin e këtij programi janë pasur parasysh metodologjitë bashkëkohore të planifikimit dhe programimit kurrikular të dijeve në shkollë.

- a. *Konsolidimi i ndryshimeve në programin e fundit.* Zbatimi i këtij programi në vitet e fundit tregoi se këto ndryshime ishin të drejta dhe pasqyronin rikonceptimin e objektit të gjeografisë mbi bazën e kërkesave të zhvillimeve të reja në Botë e në vendin tonë dhe të zhvillimeve në vazhdim të shekullit të ri.
 - *Përmbajtja lëndore e programit është rikonceptuar mbi bazën e kriterëve dhe koncepteve të gjeografisë së sotme shkollë:* trajtime dhe analiza të ndërthura të problemeve fiziko-gjeografike, sociale dhe ekonomike në vështrim të përgjithshëm dhe sipas rajoneve. Kjo jep mundësi që të formohen koncepte të qarta shkencore për veçoritë gjeografike të natyrës, të shoqërisë dhe të ekonomisë; për bashkëveprimin e tyre në përcaktimin e fizionomisë së peizazhit gjeografik shqiptar; për vlerat dhe pasuritë e këtij peizazhi; për shkallën e zhvillimit social-ekonomik të trevave shqiptare dhe për perspektivën e zhvillimit të tyre etj.
 - *Sipas konceptimit rajonal, trajtohen për herë të parë të gjitha trevat shqiptare së bashku:* Republika e Shqipërisë, Kosova, trevat shqiptare në Serbi, Maqedoni, Mal të Zi dhe Greqi. Kjo do t'u japë mundësi nxënësve që t'i njohin të gjitha trevat shqiptare në Ballkan, shkaqet historike të copëtimit; veçoritë natyrore, sociale dhe ekonomike; perspektivat e zhvillimit të tyre në kuadrin e bashkëpunimit midis trevave shqiptare dhe më gjerë në shkallë rajonale dhe Evropiane.
 - *Vend të rëndësishëm në programin e ri zenë trajtimet e problemeve të mjedisit,* duke venë theksin mbi shkaqet e dëmtimit, ndotjes dhe degradimit, mbi pasojat e këtij dëmtimi, mbi mundësitë dhe rrugët e mbrojtjes së tij, mbi përgjegjësitë e gjithsecilit për mbrojtjen e mjedisit ku ai jeton dhe punon. Ky trajtim do të ndihmojë edhe në formimin e një edukate të qëndrueshme ekologjike.
 - *Vëmendje të veçantë ky program u kushton punëve praktike, me përmbajtje të re.* Në këto punë praktike nxënësit, duke rritur punën e tyre vetiake, do të aftësohen për të evidentuar, analizuar dhe interpretuar lidhjet dhe raportet midis natyrës, popullsisë dhe ekonomisë.
 - *Programi është lehtësuar nga hollësitë e panevojshme, nga tepërimet në trajtesat e problemeve fizike, duke i lënë vend më të madh koncepteve, shprehive dhe vlerave gjeografike më të domosdoshme për t'u orientuar në përballimin e sfidave të jetës në shekullin e ri.*

- b. *Ndryshimet e tjera në programin e ri* lidhen me zhvillimet e reja në fushën e gjeografisë dhe në metodologjitë bashkëkohore të hartimit dhe të zbatimit të kurrikulave të gjeografisë shkollore. Ndër to theksojmë:
- *Trajtimi i pasurive të mjedisit të trevave shqiptare, të diferencuara në të ripërtëritshme dhe të paripërtëritshme, në të përgjithshme dhe të veçanta.* Tek të fundit, vend i rëndësishëm i kushtohet trashëgimisë natyrore dhe kulturore shqiptare, vlerave të tyre, faktorëve dhe shkallës së dëmtimit, rrugëve të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit për qëllime shkencore, turistike, edukuese, atdhetare dhe ekologjike, etj;
 - *Në krahasim me programin e mëparshëm, ku brendia lëndore ishte e organizuar me struktura statike e uniforme, ky program i ri është hartuar sipas strukturave bashkëkohore të planifikimit dhe programimit kurrikular.* Elementët përbërës të strukturës do të ndikojnë në rritjen e shkallës së fleksibilitetit të zbatimit të këtij programi. Objektivat e përgjithshëm dhe ato kryesorë të kësaj disipline shkollore *përfaqësojnë standardet shtetërore të formimit gjeografik të nxënësve të cilat janë të detyrueshme për t'u realizuar.* Këto objektiva do të orientojnë hartuesit e botuesit e teksteve, mësuesit në detajimin dhe përcaktimin e temave konkrete dhe përmbajtjes së tyre, të objektivave specifike të çdo teme dhe çdo ore mësimore. Kjo mënyrë e re e parashtrimit të përmbajtjeve lëndore dhe e përcaktimit të orëve mësimore vetëm në bazë problematike do t'u japë më shumë liri mësuesve, të cilët, duke u nisur nga kushtet konkrete (nxënësit, pajisjet etj.), mund të zgjedhin njohuritë, shpehitë gjeografike të parashikuara për t'u përvetësuar nga nxënësit. Në dispozicion të mësuesit janë dhe dhjetë orë të lira, të cilat ai mund t'i përdorë sipas kushteve konkrete të zbatimit të programit, por gjithmonë me synimin për të realizuar me cilësi objektivat dhe kërkesat e lëndës të theksuar në këtë program. Për këtë qëllim do ta ndihmojnë udhëzimet që jepen në lidhje me metodologjitë e zbatimit të programit dhe të vlerësimit të nxënësve.

Rikonceptimi i përmbajtjes lëndore dhe organizimi i saj sipas struktues kurrikulare do t'i ballafaqojë hartuesit dhe botuesit e tekstit si dhe mësuesin me një detyrë më të vështirë, por mjaft krijuese dhe stimuluese. Me këtë program të ri ata do të kenë mundësi më të mëdha për të përpunuar, administruar, verifikuar dhe vlerësuar punën e tyre, por tashmë, duke u mbështetur në objektivat dhe qëllimet finale, nën drejtimin e të cilave duhet të ndërtojnë dhe zbatojnë tërë veprimtaritë e tyre.

Theksojmë se programi kërkon që të respektohen parimet bazë, si: cikli i hapur dhe i rimarjes së koncepteve nga klasat më të ulta, masa optimale dhe shmangia e mbingarkesës, mbështetja në vrojtime, interpretime dhe analiza vetiake të dukurive gjeografike nga nxënësit etj.

Ky program është konceptuar në ndihmë të dy kategorive të mëdha të të interesuarve:

- hartuesit dhe botuesit e teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për nxënësit e mësuesit;

- mësuesit, nxënësit, prindërit etj.

2. SYNIMET E LËNDËS

Objekti i lëndës

Gjeografia për klasën e nëntë të shkollës 9 vjeçare ka për objekt: natyrën, popullsinë dhe ekonominë e trevave shqiptare, lidhjen e ndërsjelltë ndërmjet natyrës dhe zhvillimit e organizimit hapësinor të veprimtarisë jetësore e prodhuese të shoqërisë si dhe studimin tërësor të rajoneve gjeografike shqiptare.

Në përfundim të studimit të lëndës nxënësit duhet:

1. Të njohin dukuritë kryesore fiziko–gjeografike dhe humane të hapësirës gjeografike të trojeve shqiptare.
2. Të njihen me faktorët dhe kushtet e organizimit dhe strukturimit të hapësirës gjeografike të trevave shqiptare në rajone të veçanta dhe me tiparet natyrore dhe humane të këtyre rajoneve;
3. Të njohin objektet kryesore gjeografike të trevave shqiptare, shtrirjen dhe dukuritë kryesore të tyre, duke përdorur dhe lexuar hartat e ndryshme të trojeve shqiptare dhe burimet e tjera të njohurive gjeografike për to.
4. Të kenë koncepte të qarta për rolin e faktorëve natyrorë në strukturimin, zhvillimin dhe shpërndarjen hapësinore të dukurive e proceseve gjeografike të rajoneve shqiptare.
5. Të njohin ndikimin dhe rolin determinues të veprimtarisë jetësore e prodhuese të shoqërisë në zhvillimin social-ekonomik dhe emancipues të trevave shqiptare.
6. Të kuptojnë lidhjet e gjendjes së mjedisit gjeografik të trojeve shqiptare me veprimtaritë jetësore të shoqërisë dhe mbi këtë bazë të dinë të zbatojnë rregullat e mbrojtjes së mjedisit nga ndotja e degradimi.
7. Të njohin trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajoneve gjeografikë të trevave shqiptare, vlerat e tyre, shkallën e dëmtimit dhe mënyrat e mbrojtjes dhe shfrytëzimit shkencor të tyre;
8. Të jenë të aftë të ndërmarrin projekte mësimore për njohjen dhe zgjidhjen e problemeve që shfaqen në mjedisin e tyre të afërt gjeografik.
9. Të duan, të nderojnë dhe të jenë krenarë për vendin e tyre, për vëllezërit shqiptarë kudo që ndodhen, pavarësisht nga barierrat kufitare, ndryshimet dhe veçoritë kulturore, ekonomike, fetare etj.
10. Të jenë tolerantë, të pranojnë zhvillimet dhe ndryshimet; të jenë të gatshëm për të bashkëjetuar dhe bashkëvepruar me pakicat e tjera etnike që jetojnë në trojet shqiptare, por dhe me kombet dhe popujt fqinjë, të Ballkanit, të Evropës dhe Botës.

Objektivat kryesore të lëndës

1. Të shpjegojnë arsyet e copëtimit të trevave shqiptare në periudha të ndryshme historike dhe statusin e tyre aktual politik;

2. Të formohen me konceptet aktuale mbi marrëdhëniet e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit midis vendeve e popujve fqinjë e më gjerë dhe të njihen me të ardhmen e të gjitha trevave shqiptare dhe të shteteve ku ato ndodhen në familjen e madhe evropiane;
3. Të njohin pasuritë kryesore natyrore dhe mënyrat e shfrytëzimit racional të tyre.
4. Të shpjegojnë ndikimin e faktorëve natyrorë e social-ekonomikë në formimin e tipareve të peizazheve gjeografike të trevave shqiptare.
5. Të tregojnë shtrirjen e hapësirave gjeografike të trevave shqiptare, kufijtë dhe madhësinë e tyre.
6. Të përshkruajnë ndikimin e faktorëve gjeografikë në krijimin e larmisë së theksuar të ndërtimit gjeologjik, relievit, klimës, hidrografisë, tokave, botës bimore e shtazore në shkallë rajonale e vendore.
7. Të argumentojnë shkaqet e ndotjes së mjedisit gjeografik në trevat shqiptare dhe rrugët e mbrojtjes së mjedisit të tyre.
8. Të shpjegojnë shkaqet dhe pasojat e ndryshimeve sociale, politike dhe ekonomike të rajoneve shqiptare, të para në këndvështrimin hapësinor.
9. Të përshkruajnë veçoritë kryesore gjeografike të trevave shqiptare në tërësi dhe të rajoneve e nënrajoneve të tyre në veçanti.
10. Të përcaktojnë vendndodhjet e objekteve dhe dukurive kryesore gjeografike në trevat dhe rajonet gjeografike shqiptare.
11. Të njohin veçoritë strukturore dhe të shpërndarjes hapësinore të popullsisë së rajoneve shqiptare.
12. Të përshkruajnë karakteristikat e ndërtimit strukturor dhe modelimet e organizimit hapësinor të ekonomisë së rajoneve gjeografike, gjendjen e zhvillimit aktual dhe prirjet e së ardhmes.
13. Të hartojnë përshkrime gjeografike për peizazhet e ndryshme fizike e humane shqiptare.
14. Të grumbullojnë dhe të klasifikojnë të dhëna të karakterit gjeografik në shkallë vendore, t'i analizojnë e të nxjerrin përfundime të pavarura prej tyre.
15. Të plotësojnë hartat memecë të trevave dhe rajoneve të veçanta shqiptare.
16. Të gjejnë shkaqet e mundshme të shpërndarjes së objekteve gjeografike në një nga rajonet shqiptare.
17. Të përshkruajnë, në mënyrë të përgjithësuar, vendndodhjen, formën dhe shpërndarjen hapësinore të vendbanimeve në hartat e rajoneve shqiptare.
18. Të përshkruajnë veçoritë e rrjetit të komunikacionit të paraqitura në një hartë, sipas tipit, dendësisë dhe drejtimit dhe të zbulojnë lidhjen e këtij rrjeti me relievin, hidrografinë, ekonominë etj.
19. Të vizatojnë dhe të plotësojnë (në terren) një skicë të peizazhit fshatar ose qytetar të zonës ose të rajonit ku jetojnë.
20. Të nxjerrin përfundime që rrjedhin nga aktiviteti njerëzor në rajonin e tyre, duke përcaktuar raportin ndërmjet veprimtarisë ekonomike mbizotëruese dhe organizimit të territorit në një nga hartat e rajoneve shqiptare.
21. Të "lexojnë" hartat e ndryshme tematike të trevave dhe rajoneve shqiptare dhe t'i përdorin ato si burime për fitimin e njohurive të reja.
22. Të përdorin njohuritë dhe shprehjet gjeografike gjatë punës së pavarur për realizimin e projekteve mësimore.

3. TEMATIKAT KRYESORE TË PËRMBAJTJES

1. Pozita gjeografike, përbërja e trevave shqiptare dhe harta politike e tyre;
2. Natyra e trevave shqiptare;
3. Popullimi i trevave shqiptare;
4. Ekonomia e trevave shqiptare;
5. Probleme mjedisore të trevave shqiptare;
6. Rajonet gjeografike të Shqipërisë dhe veçoritë e tyre.
7. Trevat shqiptare përtej kufirit të Republikës së Shqipërisë

4. OBJEKTIVAT KRYESORE SIPAS PËRBËRËSVE TË PËRMBAJTJES

Tematika	Kreu/Objektivat	Konceptet	Numri i orëve
Pozita gjeografike dhe harta politike e trevave shqiptare	<p>Në fund të klasës së nëntë, nxënësi/ja duhet të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të njohë pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Ballkan, në Evropë dhe në Mesdhe; të interpretojë rolin e kësaj pozite në dukuritë natyrore, popullimin dhe zhvillimin social – ekonomik të tyre. ➤ Të njohë dhe të interpretojë proceset historike, politike dhe gjeografike që përcaktuan ndryshimet dhe formimin e hartës politike të trevave shqiptare, shkaqet e copëtimit të tyre në disa shtete ballkanike; statusi i sotëm politik dhe e ardhmja e tyre në familjen e madhe evropiane. ➤ Të njohin përbërjen e trevave shqiptare, vendosjen e tyre sipas shteteve, t’i dallojnë ato në hartën politike të Evropës Juglindore. 	<p>Pozita gjeografike e trevave në Ballkan dhe roli i tyre në zhvillimin e tyre.</p> <p>Faktorët historikë, politikë dhe gjeografikë që ndikuan në ndryshimin e hartës politike.</p> <p>Njohja me vendndodhjen e trevave shqiptare.</p>	2
Natyra e trevave shqiptare	<p>Në fund të klasës së nëntë, nxënësi/ja duhet të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të vlerësojë rolin e pozitës gjeologjike, të formimit dhe të përbërjes së truallit të trevave shqiptare në larminë e dhe shumëllojshmërinë e pasurive minerare të tyre; mundësitë që ofrojnë këto pasuri në zhvillimin e tyre. ➤ Të shpjegojë veçoritë kryesore dhe larminë e formave të relievit të trevave shqiptare, të njohë shtrirjen e elementëve kryesorë të këtij relievi dhe të interpretojë rolin e tyre në dukuritë natyrore, në popullimin dhe në zhvillimin ekonomik; të njohë hartën fizike të trevave shqiptare, vendosjen e elementëve kryesorë të relievit 	<p>Pozita gjeologjike dhe pasuritë minerale që zotërojnë trevat shqiptare.</p> <p>Faktorët që ndikojnë në format e relievit.</p> <p>Interpretimi i hartës fizike të trevave shqiptare.</p>	4

	<p>të tyre dhe të evidentojnë shpërndarjen e qendrave të banuara në format kryesore të tij.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shpjegojë veprimin e faktorëve të formimit të klimës, veçoritë kryesore dhe larminë e saj në trevat shqiptare, tiparet e elementëve kryesorë klimatikë dhe të vlerësojnë pasuritë klimatike dhe mënyrën e shfrytëzimit të tyre për qëllime ekonomike dhe turistike; të ndërtojë dhe të interpretojë grafikët e regjimit të elementëve kryesorë klimatikë. ➤ Të interpretojë rolin e faktorëve dhe kushteve të formimit të hidrografisë së trevave shqiptare, të përbërjes së saj me larmi objektsh hidrografike, të regjimit të rrjedhjes, të veçorive kryesore të këtyre objekteve; të vlerësojë pasuritë ujore dhe potencialet turistike të brigjeve detare dhe liqenore, mënyrën e shfrytëzimit të tyre për qëllime ekonomike dhe turistike; të njohë shkaktarët e ndotjes së ujit dhe rrugët e mbrojtjes së kësaj pasurie; të ndërtojë dhe të interpretojë grafikët e regjimit të rrjedhjes dhe të njohë hartën e rrjetit hidrografik të trevave shqiptare. ➤ Të shpjegojë konceptin toka pjellore dhe të varfëra, të njohë faktorët dhe shkaqet e dëmtimit, degradimit dhe ndotjes së tokave, rrugët e mbrojtjes së tyre. ➤ Të shpjegojë shkaqet e larmisë së bimësisë dhe të botës shtazore të trevave shqiptare; përbërjen e saj sipas kateve bimore, llojet e kafshëve të egra; të njohë pasuritë floristike dhe faunistike, shkallën e dëmtimit dhe degradimit të mbulesës bimore dhe rrugët e mbrojtjes dhe ripërtëritjes së saj. 	<p>Faktorët që ndikojnë në formimin e klimës. Shfrytëzimi i klimës në favor të ekonomisë dhe turizmit. Pasuritë ujore dhe roli i tyre në ekonomi. Shkaktarët e ndotjes dhe rrugët për mbrojtjen e pasurive ujore.</p> <p>Faktorët që e bëjnë një tokë pjellore dhe jo-pjellore.</p> <p>Flora dhe fauna .Roli që luajnë në formimin e ekosistemit.</p>	
<p>Popullimi i trevave shqiptare</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë, nxënësi/ja duhet të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të njohë konceptin e organizimit administrativ të territorit të 		<p>3</p>

	<p>trevave shqiptare, faktorët dhe ndryshimet gjatë historisë së skemës së organizimit të territorit të trevave shqiptare; të njohë skemat aktuale administrative të tyre dhe të shpjegojë rolin e organizimit shtetëror dhe administrativ në rregullimin dhe administrimin e territorit.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shpjegojë faktorët dhe kushtet e popullimit të hershëm të trevave shqiptare; të popullimit të vazhdueshëm të tyre; faktorëve dhe të treguesve të rritjes së numurit të popullsisë; të shpërndarjes gjeografike dhe ndryshimeve të treguesve të shtimit natyror dhe të dendësisë së popullsisë, të strukturës moshore dhe gjinore, kombëtare dhe fetare të popullsisë. ➤ Të shpjegojë faktorët dhe pasojat e migrimëve të popullsisë së popullsisë shqiptare sipas trevave; ➤ Të shpjegojë dukuritë e vendbanimeve rurale dhe urbane, shkaqet e ndryshimeve të strukturës dhe të arkitekturës të ndërtesave si dhe të problemeve mjedisore të tyre. ➤ Të ndërtojë dhe të analizojë grafikët e strukturës së popullsisë dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të saj. 	<p>Mënyra e organizimit administrativ në pushtetin lokal dhe qendror.</p> <p>Historiku i formimit të trevave shqiptare dhe ndryshimet demografike. Migracioni dhe shkaqet e tij. Struktura e vendbanimeve të trevave shqiptare. Struktura e popullsisë.</p>	
Ekonomia e trevave shqiptare	<p>Në fund të klasës së nëntë, nxënësi/ja duhet të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shpjegojë premiset dhe resurset natyrore dhe njerëzore për zhvillimin ekonomik të trevave shqiptare; rolin e faktorëve historikë dhe politikë në zhvillimin e tyre ekonomik, të njohë të ardhmen e këtij zhvillimi. ➤ Të interpretojë strukturën ekonomike të trevave shqiptare, bazat natyrore dhe traditat e zhvillimit të bujqësisë, strukturën e degëve të saj dhe ndryshimet në kohë dhe në hapësirë të nivelit dhe të strukturës së prodhimit bujqësor, shkallën e plotësimit të kërkesave të tregut me produkte vendase bujqësore; rajonet 	<p>Resurset natyrore Resurset njerëzore</p> <p>Strukturë ekonomike</p> <p>Kërkesa e tregut</p>	4

	<p>kryesore bujqësore dhe të ardhmen e prodhimit bujqësor</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të evidentojë burimet natyrore si bazë për zhvillimin e industrisë dhe shkallën e zhvillimit të saj; të shpjegojë faktorët që kanë kushtëzuar këtë shkallë zhvillimi; ➤ Të shpjegojë strukturën e industrisë, ndryshimin e saj në etapat kryesore të zhvillimit dhe sipas trevave shqiptare, në situatën e sotme dhe perspektivën e prodhimit industrial; ➤ Të interpretojë strukturën e sektorit terciar të ekonomisë; gjendjen e transportit, strukturën dhe dendësinë e arterieve të llojeve të transportit, shkaqet dhe shkallën e zhvillimit; gjendjen e tregëtisë, artizanatit dhe të shërbimeve, strukturën e tyre dhe shkaqet e ndryshimeve në kohë dhe hapësirë të tyre; ➤ Të evidentojë dhe të shpjegojë potencialet natyrore, njerëzore dhe ekonomike për zhvillimin e turizmit, përparësitë, shkallën e zhvillimit dhe perspektivën e tij; ➤ Të ndërtojë dhe të analizojë grafikët e strukturës së ekonomisë dhe degëve të saj si dhe hartat e shpërndarjes gjeografike të rajoneve kryesore bujqësore dhe industriale të trevave shqiptare. 	<p>Rajon bujqësor</p> <p>Burime natyrore</p> <p>Struktura e industrisë</p> <p>Sektori terciar</p> <p>Potenciale natyrore</p> <p>Potenciale njerëzore</p> <p>Rajon industrial</p>	
<p>Probleme mjedisore të trevave shqiptare</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë, nxënësi/ja duhet të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të evidentojë dhe të vlerësojë pasuritë e mjedisit të trevave shqiptare, të diferencuara në të përsëritshme dhe të papërsëritshme, në të përgjithshme dhe të veçanta, unikale; ➤ Të vlerësojë rolin dhe vendin e pasurive mjedisore në shkallën e zhvillimit të trevave shqiptare; ➤ Të evidentojë dhe të vlerësojë shkaqet e problemeve të sotme mjedisore, si: ndotjen e ajrit, ujit, dhe të tokës, dëmtimin e 	<p>Pasuri mjedisore të përtëritshme</p> <p>Pasuri mjedisore të pa përtëritshme</p> <p>Ndotje ajri</p> <p>Ndotje uji</p>	<p>3</p>

	<p>biodiversitetit, të sipërfaqeve të gjelbërta dhe të faunës, degradimin dhe shkretërizmin e tokës dhe të peizazheve nga erozioni, dhe rrugët e mbrojtjes së mjedisit dhe të zgjidhjes së problemeve të sotme tepër të mprehta mjedisore etj;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të vlerësojë trashëgiminë natyrore dhe kulturore si burim për studime shkencore, zhvillimin e turizmit, edukim atdhetar dhe ekologjik; të njohë kategoritë e zonave të mbrojtura dhe të trashëgimisë kulturore; ➤ Të vlerësojë mbrojtjen e mjedisit dhe të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të trevës së tyre. 	<p>Ndotje toke Biodiversitet</p> <p>Trashëgimi natyrore Trashëgimi kulturore</p> <p>Mbrojtje e mjedisit</p>	
<p>Përbërja e trevave shqiptare, rajonet gjeografike dhe veçoritë e tyre</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë, nxënësi/ja duhet të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të njohë të gjitha trevat shqiptare, përbërjen, shtrirjen, kufijtë, pozitën gjeografike të tyre në raport me polet urbane dhe akset kryesore të transportit. ➤ Të njohë dhe të vlerësojë pozitën gjeografike të Shqipërisë në dukuritë fiziko-gjeografike, në popullimin dhe zhvillimin social – ekonomik; vlerat e veçanta të pozitës tranzit të vendit tonë midis lindjes dhe perëndimit. ➤ Të shpjegojë tiparet e përgjithshme të natyrës, popullsisë, ekonomisë të Shqipërisë, faktorët e zhvillimit, shkaqet e gjendjes aktuale, ndryshimet gjatë etapave të ndryshme, problemet aktuale, perspektivat e zhvillimit në të ardhmen në kuadrin kombëtar, rajonal dhe më gjerë. ➤ Të shpjegojë shkaqet dhe faktorët e diferencimit rajonal të hapësirës gjeografike të Shqipërisë dhe tiparet kryesore të rajoneve të saj gjeografikë. ➤ Të shpjegojë rolin e pozitës gjeografike në veçoritë natyrore dhe 	<p>Pole urbane Akse rrugore</p> <p>Pozita gjeografike</p> <p>Etapa zhvillimi</p> <p>Diferencim rajonal Hapësirë gjeografike</p>	<p>18</p>

	<p>sociale ekonomike të Rajonit Verior dhe Verilindor të Shqipërisë; shkaqet e diferencimit të tij në nënrajone.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shpjegojë shkaqet e larmisë së theksuar të natyrës së Alpeve Shqiptare; ofertat dhe resurset natyrore të tyre për popullim; ➤ Të evidentojë gjurmët e popullimit të hershëm të Alpeve shqiptare, veçoritë e këtij popullimi, ndikimin e fuqishëm të faktorëve natyrorë në popullimin e pakët të tyre, shkaqet e izolimit dhe të traditave të pasura materialo-shpirtërore; problemet e kohëve të fundit të lidhura me migrimin e popullsisë së tyre drejt rajoneve fushore të vendit; ➤ Të vlerësojë kushte e vështira për zhvillim e bujqësisë në Alpet, strukturën ekonomike si nënrajon blegtoral dhe bujqësor; potenciale të mëdha për zhvillimin e disa llojeve të turizmit, të pylltarisë dhe të blegtorisë; ➤ Të evidentojë përparësitë e pozitës gjeografike të nënrajonit verilindor, shkaqet e larmisë natyrore, dukuritë fiziko gjeografike dhe pasuritë e shumta dhe të larmishme natyrore të këtij nënrajonit, diferencimin e tij në nënjesi përbërëse; ➤ Të evidentojë gjurmët e popullimit të hershëm të nënrajonit verilindor, veçoritë e këtij popullimi, ndikimin e faktorëve natyrorë në popullimin dhe në ecurinë e treguesve të popullimit dhe të strukturës demografike; ➤ Të shpjegojë veçoritë e vendbanimeve; vendosjen e tyre në forma të ndryshme të relievit dhe shpërndarjen në drejtim vertikal, nivelet e urbanizimit; ndryshimet midis nënjesive përbërëse të tyre; trashëgiminë e pasur materialo-shpirtërore; problemet e kohëve të fundit të lidhura me migrimin e popullsisë së tyre drejt rajoneve fushore të vendit; ➤ Të shpjegojë kushtet e zhvillimit ekonomik të nënrajonit verilindor dhe të nënjesive përbërëse, ndikimin e faktorëve natyrorë, socialë e politikë në këtë zhvillim, nivelet e zhvillimit, 	<p>Vecori natyrore Rajon Nënrajon Resurse natyrore Oferta</p> <p>Migram Pasuri materiale-shpirtërore</p> <p>Nënrajon blegtoral Potenciale</p> <p>Nënjësi përbërëse</p> <p>Strukturë demografike</p> <p>Nivele të urbanizimit</p> <p>Kushte të zhvillimit ekonomik Aktivitet ekonomik</p>	
--	--	--	--

	<p>strukturën e degëve të ekonomisë, zhvillimin e industrisë minerare, metalurgjisë me ngjyra dhe të hidroenergjisë dhe problemet e sotme të tyre; mundësitë e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme ekonomike, të turizmit etj;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shpjegojë kushtet natyrore të Rajonit Juglindor, veçoritë e pozitës gjeografike dhe të përparësive të saj, të relievit dhe të ofertave të tij për popullim dhe zhvillimin e bujqësisë; të dukurive klimatike, hidrografike, të tokave dhe botës së gjallë, problemeve mjedisore dhe të trashëgimisë natyrore dhe të pasurive në tërësi të rajonit; ➤ Të evidentojë gjurmët e popullimit të hershëm të Rajonit Juglindor, kushtet natyrore që ndikuan në këtë popullim dhe në shtimin e vazhdueshëm të dendësisë së popullimit; ecurinë e tij në shekullin e XX dhe shkaqet e shtimit të pakët; problemi i migrimeve të popullsisë; strukturën e popullsisë dhe ndryshimet e saj në kohë dhe sipas nënjësive përbërëse; problemet e kohëve të fundit të lidhura me migrimin e popullsisë ➤ Të shpjegojë veçoritë e vendbanimeve; vendosjen e tyre në forma të ndryshme të relievit dhe shpërndarjen në drejtim vertikal, nivelet e urbanizimit; tiparet e veçanta të qendrave urbane dhe rurale; trashëgiminë e pasur materialo-shpirtërore; ➤ Të shpjegojë kushtet e zhvillimit ekonomik të Rajonit Juglindor dhe të nënjësive përbërëse, ndikimin e faktorëve natyrorë, socialë e politikë në këtë zhvillim, nivelet e zhvillimit, strukturën e degëve të ekonomisë, zhvillimin e industrisë minerare dhe problemet e sotme të tyre; mundësitë e zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme ekonomike, të turizmit etj; ➤ Të shpjegojë kushtet natyrore të Rajonit Jugor; veçoritë dhe përparësitë e pozitës gjeografike; veçoritë mesdhetare të kushteve natyrore: relievit, klimës, hidrografisë, tokave dhe botës së gjallë, pasurive natyrore, problemeve mjedisore dhe të trashëgimisë 	<p>Kushte natyrore Dukuri klimatike Dukuri hidrografike</p> <p>Migrimi i popullsisë</p> <p>Vendbanim i hershëm Qendër urbane Qendër rurale Faktorë socialë Faktorë politikë</p> <p>Bota e gjallë Probleme mjedisore</p> <p>Shtim i pakët i popullsisë</p>	
--	---	---	--

	<p>natyrore;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të evidentojë gjurmët e popullimit të hershëm të Rajonit Jugor, kushtet natyrore që ndikuan në këtë popullim dhe në shtimin e vazhdueshëm të dendësisë së popullimit; shkaqet e shtimit të pakët në shekullin e fundit; problemi i migrimeve të popullsisë; strukturën e popullsisë dhe ndryshimet e saj në kohë dhe sipas nënjësive përbërëse; problemet e kohëve të fundit të lidhura me migrimin e popullsisë. ➤ Të shpjegojë veçoritë e vendbanimeve; vendosjen e tyre në forma të ndryshme të relievit dhe shpërndarjen në drejtim vertikal, nivelet e urbanizimit; tiparet e veçanta të qendrave urbane dhe rurale; trashëgiminë e pasur materialo-shpirtërore; ➤ Të shpjegojë kushtet dhe veçoritë e zhvillimit ekonomik të rajonit dhe të aktiviteteve ekonomike; rajonet bujqësore dhe strukturën e prodhimit bujqësor, tendencat e zhvillimit ekonomik në të ardhmen; mundësitë e zhvillimit të turizmit; ➤ Të shpjegojë kushtet natyrore të Rajonit Perëndimor; prioritet e pozitës gjeografike, të relievit, klimës, hidrografisë, tokave për popullim dhe zhvillim social ekonomik, problemet mjedisore dhe trashëgimia natyrore e tij; ➤ Të evidentojë gjurmët e popullimit të hershëm të Rajonit Perëndimor; rolin e kushteve natyrore në këtë popullim, shkaqet e shtimit të shpejtë të popullsisë pas bonifikimeve dhe pas vitit '90; të përqëndrimit të madh të popullsisë dhe vendbanimeve qytetare dhe rurale; të shpjegojë pasojat e imigrimit të popullsisë në këtë rajon nga rajonet e tjera të vendit dhe pasojat në treguesit demografikë si: dendësi e përqindje e lartë e popullsisë qytetare, ndryshime në strukturën e popullsisë etj ➤ Të shpjegojë veçoritë e qendrave të banuara, shkaqet e urbanizimit të shpejtë të rajonit, tiparet e qytetet më të mëdhenj të vendit dhe të funksioneve të shumta të tyre; veçoritë strukturore 	<p>Shpërndarje në drejtim vertikal</p> <p>Mundësi zhvillimi</p> <p>Trashëgimia natyrore</p> <p>Popullim i hershëm Përqëndrim i popullsisë</p> <p>Probleme demografike Lëvizje e popullsisë</p> <p>Tendencë zhvillimi</p> <p>Shërbimet në ekonomi</p>	
--	---	--	--

	<p>të qendrave të banuara rurale; problemet e krijuara në vitet e fundit nga lëvizja e popullsisë, etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shpjegojë shkaqet dhe kushtet e zhvillimit të ekonomisë së rajonit në etapa të ndryshme, tendencat e zhvillimit të tij në kohën e sotme; strukturën e aktiviteteve ekonomike të bujqësisë, industrisë, shërbimeve, transportit, turizmit dhe shkaqet e zhvillimeve të shpejta të tyre pas vitit '90. ➤ Të ndërtojë dhe të interpretojë grafikët dhe hartat e popullsisë dhe të shpërndarjes gjeografike të aktiviteteve ekonomike në rajoneve të ndryshme të vendit. 		
<p>Trevat shqiptare përtej kufirit të Republikës së Shqipërisë</p>	<p>Në fund të klasës së nëntë, nxënësi/ja duhet të jetë i/e aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shpjegojë veçoritë e kushteve natyrore, të pasurive natyrore dhe të kushteve e faktorëve të popullimit dhe të zhvillimit social ekonomik; ➤ Të shpjegojë shkaqet e ecures së popullimit, të ndryshimeve strukturore të popullsisë dhe të përbërjes etnike të tyre, të përpjekjeve të bëra në të kaluarën nga regjimet e shteteve ku ato bëjnë pjesë për çpopullimin e këtyre trevave nga shqiptarët dhe popullimin e tyre me popullsi jo shqiptare, gjendja e statusit të tyre politik dhe e ardhmja e tyre në familjen e madhe evropiane; ➤ Të evidentojë dhe shpjegojë problemet e shumta të zhvillimit të tyre social ekonomik dhe raportet e këtij zhvillimi me rajonet e tjera gjeografike të shtetit ku ato ndodhen; ➤ Të njohë pozitën gjeografike të Kosovës, përparësitë e saj, kushtet natyrore dhe pasuritë e saj natyrore; trashëgiminë natyrore dhe problemet e saj; ➤ Të shpjegojë popullimin e lashtë të Kosovës nga ilirët të shqiptarët, kohën e ardhjes së sllavëve, përbërjen etnike dhe 	<p>Zhvillim social Zhvillim ekonomik</p> <p>Çpopullim Status</p> <p>Përparësi e pozitës gjeografike</p> <p>Probleme të trashëgimisë natyrore</p> <p>Përbërje etnike Shkaqe të luftës në</p>	<p>10</p>

	<p>përpyjekjet për ndryshimin e saj; migrimet e popullsisë dhe pasojat; statusi politik i Kosovës në periudha të ndryshme problemet e të drejtave të popullsisë shqiptare në periudha të ndryshme; shkaqet e luftës në Kosovë, ecuria e problemeve të Kosovës dhe zgjidhja përfundimtare e statusit të saj;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të shpjegojë veçoritë e qendrave të banuara, shpërndarjen gjeografike, vendosjen e tyre në raport me format e relievit dhe burimet natyrore, tiparet e qendrave rurale dhe urbane; shkallën e urbanizimit dhe të tendencën e saj; ➤ Të shpjegojë veçoritë e zhvillimit ekonomik të Kosovës në periudha të ndryshme, të strukturës dhe shkaqet e zhvillimit të ngadalshëm; gjendja në kohën e sotme dhe perspektivat e tij. ➤ Të njohë rajonet gjeografikë të Kosovës, shtrirjen dhe veçoritë e kushteve natyrore, të popullimit dhe zhvillimit ekonomik; ➤ Të njohë shtrirjen e trevave shqiptare në Sërbi, Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës, statusin politik të tyre, veçoritë natyrore, të popullsisë, ekonomisë. ➤ Të njohë shtrirjen e trevave shqiptare në Maqedoninë Perëndimore, veçoritë dhe përparësitë e pozitës gjeografike, të shtrirjes gjeografike, të tipareve fiziko-gjeografike dhe pasuritë natyrore, të statusit politik, të popullimit dhe të ecurisë, të përbërjes etnike, të ecurisë së strukturës së popullsisë, të tipareve të qendrave të banuara urbane dhe rurale; veçoritë e zhvillimit ekonomik të këtyre trevave; ➤ Të njohë shtrirjen dhe pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Mal të Zi, statusin politik të tyre, tiparet fiziko-gjeografike dhe pasuritë natyrore, të popullimit dhe autoktonisë së popullsisë shqiptare, të numrit të popullsisë, strukturës dhe karakterit të migrimeve të popullsisë, të vendbanimeve rurale e urbane dhe veçoritë e zhvillimit të ekonomisë dhe të turizmit si degë kryesore e ekonomisë; 	<p>Kosovë Statusi i Kosovës</p> <p>Shpërndarje gjeografike Tendencë zhvillimi</p> <p>Treva shqiptare Përbërje etnike</p> <p>Tipare dalluese</p> <p>Veçori ekonomike</p> <p>Treva shqiptare të çamërisë</p>	
--	---	--	--

	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Të njohë shtrirjen dhe pozitën gjeografike të trevave shqiptare në Greqi, përbërjen e tyre (Çamëria, Grebenea, Kosturi, Follorina, etj), veçoritë fiziko-gjeografike dhe pasuritë natyrore; popullimin dhe autoktoninë e popullsisë shqiptare; statusin politik të shqiptarëve në Greqi; veçoritë e popullsisë, qendrave të urbane e rurale dhe të përbërjes etnike të tyre; veçoritë e zhvillimit të ekonomisë; ➤ Të njohë hartën e trevave shqiptare përtej kufirit, shtrirjen e objekteve kryesorë fiziko-gjeografikë, të qendrave kryesore të banuara, industriale dhe bujqësore. 	<p>Objekte fiziko-gjeografikë Qendër industriale Qendër bujqësore</p>	
--	--	---	--

V. SHPËRNDARJA E ORËVE

Gjithsej 35 javë x 2 orë në javë	70 orë
Kurrikula zyrtare	60orë
• Njohuri të reja	44 orë
• Punë praktike	10 orë
• Përsëritje	6 orë
Kurrikula në dispozicion të mësuesit	10 orë

5. SHPËRNDARJA E ORËVE

TEMAT	Numri i orëve
1. Pozita gjeografike, përbërja e trevave shqiptare dhe harta politike e tyre	2
2. Natyra e trevave shqiptare;	4
3. Popullimi i trevave shqiptare;	3
4. Ekonomia e trevave shqiptare;	4
5. Probleme mjedisore të trevave shqiptare;	3
6. Rajonet gjeografike të Shqipërisë dhe veçoritë e tyre.	18
7. Trevat shqiptare përtej kufirit të Republikës së Shqipërisë	10

6. ZBATIMI I KURRIKULËS SË LIRË

Qëllimi i orëve të lira (15% e orëve totale) është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe të përparësive që vendos mjedisi i veçantë në të cilin zhvillohet procesi i arsimimit.

Statusi i tyre është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është kompetencë e mësuesit të lëndës në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, Drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Qëllimi i orëve të lira është t'i lërë hapësirat e nevojshme iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në

përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Për mbushjen e tyre me material mësimor mund të përdoren burime të ndryshme, por gjithmonë të bëhet kujdes të punohet për arritjen e kërkesave të programit.

Grumbullimi i fakteve, shifrave e të dhënave të ndryshme historike, gjeografike, demografike, kulturore, industriale, bujqësore, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i ekskursioneve në natyrë, të shoqëruara me veprimtari praktike; organizimi i vizitave në qendra të ndryshme prodhimi të shoqëruara me vrojtme dhe të pasuara me detyra; në ferma në shërbim të një objekti të caktuar të programit; organizimi i konkurseve brenda klasës edhe për një kapitull; lojra të ndryshme zbavitëse me elementë që zhvillojnë të menduarin logjik dhe kritik; përforsimi i njohurive të shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënësit ashtu edhe mësuesin, janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efektive të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh që shfrytëzon lidhjet konceptuale ndër-lëndore dhe aspektet kroskurrikulare. Nxënësve u jepet një detyrë e cila përfshin njohuri ndër-lëndore dhe i shërben arritjes së objektiveve të programeve të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe larmia e veprimtarive, duhet të bëhet duke analizuar me kujdes si programin dhe kërkesat që parashatrojnë veçoritë vendore.

Duhet bërë kujdes që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë të cilat nuk sjellin risi të reja në kurrikulin shkollor.

Realizimi i sugjerimeve të mësuesve kërkon nga mësuesi jo vetëm aftësi krijuese, por dhe aftësinë e një krijuesi të vërtetë kurrikule, për rrjedhojë dhe përgjegjësinë profesionale dhe qytetare që bart me vete ky rol.

7. INTEGRIMI

Gjeografia duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e gjeografisë dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet dhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

1. Së pari, gjeografia mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë objektivat e saj.
2. Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin e gjeografisë për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë

Shembuj

I. Edukimi qytetar dhe Gjeografia

Lënda e gjeografisë dhe ajo e edukimit qytetar kanë të përbashkët:

1. **Konceptet:** për shembull, mjedis, rend ekonomiko-shoqëror, marrëdhënie njeri-mjedis, marrëdhënie ndërshtetërore, globalizëm, përfaqësimi, liria, etj.
2. **Aftësitë dhe shprehjet:** për shembull, përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi, etj

Gjeografia:

- u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret edukimi qytetar. Në këtë mënyrë, ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e edukimit qytetar për jetën e tyre të përditshme.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së gjeografisë dhe edukimit qytetar?

1. Së pari, kjo lidhje mund të realizohet përmes përfshirjes në kurrikulën e gjeografisë të çështjeve, të fakteve, të ngjarjeve, etj., të trajtuara në lëndën e edukimit qytetar me kusht që përmasa e mësimi të gjeografisë duhet:

- Të jetë çështja thelbësore e mësimi;
- Të lidhet me kurrikulën e edukimit qytetar;

2. Së dyti, objektivat mësimore duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të gjeografisë. Kështu, lidhja ndërmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtëm

- **Konceptet:** Karakteristikat e koncepteve (si marrëdhënia njeri-mjedis, etj) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete që lidhen me jetën e përditshme të njeriut, në të kaluarën dhe në të sotmen.
- **Tema:** Në disa mësim mund të theksohet përmasa e qytetarisë, si për shembull, në çështjet e të drejtave të njeriut.
- **Fusha kurrikulare:** Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla si demokracia etj., gjatë gjithë ciklit të shkollimit.
- **Përmasa vendore:** gjeografia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, për shembull, duke ndërmarrë projekte ku mund të përfshihen breza të ndryshëm.

3. Së treti, gjeografia ndihmon në edukimin qytetar kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme

II. Historia dhe Gjeografia

1. Çfarë kanë të përbashkët gjeografia dhe historia? Ato kanë të përbashkët:

- **Konceptet**
- **Përmbajtjen**

2. Si mund të ndihmojë lënda e gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës së historisë:

- Ndhmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike tek njerëzit dhe të bashkësia ku jetojnë;
- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe

- globale;
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë;
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qendrueshëm;
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin.

3. *Në ç' mënyrë lënda e historisë ndihmon në zhvillimin e lëndës së gjeografisë?*

- Zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e gjeografisë me jetën e përditshme të nxënësve dhe rrit interesin e tyre për to;
- Ndhmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së gjeografisë;
- Nxit të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, për shembull, tregtinë;
- Nxit nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku jetojnë, për shembull, për çështje mjedisore.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së gjeografisë dhe historisë?

1. Së pari, mësimet e gjeografisë kanë si pjesë përbërëse dhe objekt studimi mjedisin natyror. Ato duhet të lidhen me konceptet e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, qytetarisë, si për shembull, me lidhjet e ndërsjellta midis elementëve natyror dhe shoqëror të mjedisit dhe pasojat e tyre, si dhe të përfshijnë veprimtari të tilla si diskutimet etj.

2. Së dyti, përmasa e mësimi të historisë gjatë zhvillimit të temave të gjeografisë duhet:

- Të lidhet me kurrikulën e gjeografisë;

III. Shkenca dhe gjeografia

Shoqëria e sotme, vazhdimisht shtron përpara nesh çështje që lidhen me jetën tonë si në plan vetjak ashtu edhe në plan shoqëror. Trajtimi dhe zgjidhja e këtyre çështjeve, shpesh herë, kërkon jo vetëm njohuri shkencore, por edhe aftësitë dhe shprehitë për t'u përfshirë në diskutime dhe veçanërisht për të bërë gjykime kritike.

Cilat janë të përbashkëtat ndërmjet shkencës dhe gjeografisë?

- Çështjet e ndryshme rreth shkencës dhe mjedisit, për shembull, ndotja e mjedisit, çështja e ngrohjes globale;
- Ndikim i përparimeve teknike në shoqëri, për shembull, ndikim i internetit;
- Kontrolli i shkencës, për shembull, shpërndarja e fondeve për kërkime shkencore (do të përdorim miliarda lekë për të provuar që ka jetë në Mars, apo do t'i përdorim këto lekë për qëllime të tjera më të rëndësishme për shoqërinë e sotme?)

Lënda e gjeografisë duhet të ndihmojë nxënësit:

- të reflektojnë dhe të diskutojnë për rrjedhojat shoqërore të zhvillimeve ekonomike dhe shkecore;
- të vlerësojnë rolin qendror të shkencës në botën e sotme;
- të kuptojnë karakterin kontradiktor të shkencës dhe faktin që shkencëtarët kanë pikëpamje të ndryshme dhe kundërshtuese si për faktet që përdoren në shkencë

ashtu edhe për rreziqet që rrjedhin prej zhvillimeve shkencore.

Autorët e teksteve dhe mësuesit, si përdoruesit kryesorë të programit të lëndës së gjeografisë, duhet të përpiqen ose të kenë prirjen për të mbajtur parasysh mundësitë e lidhjes së kësaj lënde me lëndët e tjera. Realizimi në praktikë i kësaj lidhjeje, jo vetëm do të ndihmonte në pasurimin e argumenteve por, duke ritheksuar lidhjen e mësimit të gjeografië me aspekte të ndryshme të realitetit, do të rriste edhe motivimin e tyre për këtë lëndë.

Mësuesit duhet të zgjedhin me kujdes pjesën nga kurrikula e shkencave të natyrës dhe të përcaktojnë jo vetëm objektivat e të nxëniet por edhe mënyrën për t'i zbatuar ato qartësisht tek nxënësit.

8. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Format, metodat, strategjitë dhe teknikat e të mësuarit duhet të jenë të shumta e të larmishme. Ato zgjidhen në përshtatje me përmbajtjet lëndore, por edhe me nivelin e nxënësve, gjendjen e bazës didaktike etj. Ndër to mund të theksojmë:

- *Përshkrimi*, sidomos kur pasurohet me elementë artistikë mund të përdoret në shtjellimin e veçorive fiziko-gjeografike, duke ndikuar kështu në formimin e përfytyrimeve të qarta të kujtesës dhe të imagjinatës.
- *Biseda* do të ishte më e efektshme për ato tema për të cilat nxënësit kanë njohuri paraprake të bollshme, që fitohen nëpërmjet rrugëve të shumta të informacionit masiv.
- *Shpjegimi*, si metodë me diapazon tepër të gjerë përdorimi, mund të aplikohet me sukses në të gjitha ato veprimtari të përbashkëta të mësuesit e nxënësve, që synojnë të kuptuarit e thelbit, të shkakut ose me fjalë të tjera të origjinës së objekteve, dukurive e proceseve gjeografike dhe, rrjedhimisht, të formimit të koncepteve të sakta e të qëndrueshme për to.
- Mjaft rezultate janë edhe metodat që përfshihen në spektrin e metodave *problemore, gjysëm kërkimore e kërkimore*. Këto metoda mund të përdoren në ato raste kur nxënësit, në mënyrë individuale ose të organizuar në grupe, ndërmarrin, me ndihmën dhe drejtimin e mësuesit, veprimtari që synojnë zgjidhjen e problemeve të thjeshta të organizimit racional të hapësirës së afërt e të mesme, të mbrojtjes së mjedisit, etj.

Rendiment të lartë kanë edhe strategjitë e teknikat bashkëkohore të mësimit dhe të të nxëniet. Ndër to më të efektshme për lëndën e gjeografisë mund të jenë: *“Stuhia e mendimit”, mësimi zbulues, projekti mësimor, “harta” mendore, loja dhe konkursi gjeografik*, etj.

Të suksesshme janë gjithashtu *vëzhgimet direkte* në terren, në hapësirën përreth shkollës, ku nxënësit formojnë përfytyrime e koncepte të qarta, por edhe shprehi e vlera të dobishme për jetën.

Vetë mësuesi, duke shfrytëzuar hapësirat e lira të programit, gjatë punës së tij, mund të theksojë aspektet që përputhen me aspektet natyrore, sociale dhe ekonomike të rajonit ku ndodhet shkolla;

Shpërndarja e orëve në planin semestral e vjetor është në kompetencën e mësuesve. Në programin analitik mësuesit janë të lirë të planifikojnë shpërndarjen e orëve për temat e veçanta, por pa cënuar arritjen e objektivave lëndore. Orët e lëna në dispozicion mund të përdoren për plotësuar apo thelluar njohuritë më të domosdoshme, që lidhen me zonën ku ndodhet shkolla, për testimin e nivelit të arritjeve të nxënësve në përfundim të çdo semestri etj.

9. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Vlerësimi i nivelit dhe cilësisë së arritjes së objektivave të përmbajtjes lëndore nga nxënësit është element i rëndësishëm i procesit të të mësuarit të gjeografisë. Format dhe teknikat e vlerësimit mund të jenë të larmishme: vlerësimi sistematik, periodik ose semestral, vlerësimi me gojë, me shkrim, me teste, etj.

Verifikimi i shkallës së përgatitjes së nxënësve nëpërmjet korigjimit dhe vlerësimit sistematik me notë është ndër format më të efektshme në mësimin e gjeografisë. Sa më shumë nxënës të pyeten në orën e mësimit, por duke përdorur gjithnjë burimet e ndryshme të njohurive (hartat, grafiket, skicat, etj.), aq më i madh do të jetë sukcesi në mënjanimin e mangësive që mund të kenë ata në përvetësimin e çështjeve, njohurive, koncepteve dhe veprimtarive të veçanta gjeografike. Ky proces i vazhdueshëm i jep dorë çdo mësuesi të sqarojë, të korigjojë, të qortojojë apo të inkurajojë nxënësit, duke nxitur interesat intelektuale të tyre dhe edukuar ndjenjën e punës. Mbajtja e shënimeve për gabimet tipike të nxënësve dhe mangësitë me karakter të ndryshëm që ata kanë për njohuri e shprehje të veçanta, do ta ndihmonte mësuesin në planifikimin më të mirë të veprimtarive didaktike të ardhshme.

Kujdes i veçantë të tregohet në korigjimin dhe vlerësimin e detyrave të nxënësve, sidomos të punimeve që plotësohen hap pas hapi gjatë veprimtarive të pavarura si: punë praktike, eskursionet si dhe ato që zhvillohen për studimin e vendlindjes. Në këto raste mësuesi duhet të shënojë me hollësi natyrën e gabimeve të mundshme të shoqëruara këto me sqarimet përkatëse, por edhe të demonstrojë para klasës punimet më të mira, duke i komentuar ato.

Mjaft të efektshme për matjen e rezultateve të arritjeve të nxënësve janë edhe testimet të cilat mund të bëhen në fund të kapitujve, semestrit ose vitit shkollor. Në testet me pyetje të hapura, meqënëse nxënësit kanë të drejtë të japin përgjigje të lira e disi të gjata, duhet patur kujdes që vlerësimet të jenë të sakta dhe pa doza subjektivizmi. Në lëndën e gjeografisë përdoren me shumë sukses edhe testet objektive, nga të cilat më të rekomandueshmit janë ato që ndërtohen me pyetje me zgjedhje të shumëfishtë. Përcaktimi i blloqeve të përmbajtjeve lëndore që do të kontrollohen, sasia dhe niveli taksonomik i pyetjeve, sistemi i pikëzimit dhe mënyra e konvertimit në notë për çdo test vendosen nga mësuesit.